



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 62/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 28.04.2012, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, ashtu që Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1700 (njëmijeshatëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 26.04.2012, nga subjekti politik PDK, me të cilën pretendohet se me datën 25.04.2012 në ora 12:45 në Rrugën "Ahmet Kaçiku" në Ferizaj, subjekti politik LVV ka bërë shkelje të dispozitave ligjore duke mbuluar posterat e kandidatit për kryetar të Komunës së Ferizajt të PDK-së me posterat e kandidatit për kryetar të Komunës së Ferizajt Faton Topalli nga radhët e LVV-së. Me këtë rast parashtruesi i ankesës pretendon se LVV, ka bërë shkelje të dispozitave të Rregullës Zgjedhore 11/2009 Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, respektivisht neni 3 pika a).

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotografi nga vendi i shkeljes së supozuar.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i, e informoi LVV-në, më datë 26.04.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 27.04.2012, në ora 16:00.

PZAP-i, me datën 27.04.2011, mori përgjigjen e kërkuar brenda afatit të përcaktuar, nga LVV, në të cilën theksohet se LVV në asnjë rast nuk ka mbuluar posterat e ndonjë subjekti tjetër politik. Sipas përgjigjes në ankesë LVV potencon se pretendimet e subjektit politik PDK, se me datë 25.04.2012 në ora 12:45 e kemi mbuluar posterin e kandidatit të tyre për kryetar të komunës së Ferizajit, është tendencioz dhe i inskenuar. Po ashtu në përgjigje të ankesë potencohet se LVV e ka vizituar rrugën për të cilën parashtruesi i ankesës pretendon që është bërë shkelja e supozuar mirëpo askund nuk e kanë gjetur posterin në fjalë. Andaj sipas përgjigjes në ankesë LVV mendon se subjekti politik PDK, e ka bërë këtë më qëllim gjoja se edhe LVV ka bërë shkelje të rregullave të Fushatës Zgjedhore dhe jemi të sigurt se ky pretendim i PDK-së, është i pavërtetë dhe këtë e kanë bërë me qëllim duke e vendosur posterin e kandidatit tonë mbi posterin e kandidatit të tyre vetëm sa për ta bërë një foto dhe mandej e kanë hequr prapë.

Përgjigjes në ankesë LVV i ka bashkangjitur edhe Udhëzuesin për personat e angazhuar gjatë fushatës zgjedhore në të cilin janë të potencuar veprimet e ndaluara gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

- a) *heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik.*

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

- c) *të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).*

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

PZAP-i, përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi ndaj subjektit politik për ndonjë shkelje, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografia e dorëzuara si provë e që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se poster i kandidatit për kryetarë të komunës së Ferizajt, Faton Topalli nga radhët e LVV-së, është i vendosur mbi posterin e kandidatit për kryetarë të komunës së Ferizajt, Agim Aliu nga radhët e subjektit politik PDK, veprim të cilin PZAP-i e konstaton se është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi ankesën, mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese. PZAP-i mori si rrethanë lehtësuese, udhëzuesin e bashkangjitur në përgjigje të ankesës në të cilin shihet se LVV ka bërë përpjekje që ti njoftoi personat e angazhuar në fushatë zgjedhore lidhur me veprimet e ndaluara gjatë fushatës zgjedhore, ndërsa si rrethana rënduese gjeti se LVV ka bërë shkeljen e *Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, e cila rrethanë ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar me gjobë. Nga të gjitha arsyet e sipërshënuara dhe më qëllim të evitimit të shkeljeve të pretenduara në ankesë, dhe në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja

A nr. 62/2012 më datën 28.04.2012

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

